

Ac. nr. 638/2014

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

C.nr.334/10



GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti i Pergjithshem-divizioni civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti me procesmbajtësen Minire Krasniqi, ne ceshtjen juridike sipas padise se paditesit [redacted] nga fshati [redacted] komunae e Shtimes, te cilin e perfaqeson av. [redacted] nga Lipjani kunder te paditures Byroja Kosovare e Sigurimit Prishtine, te cilin e perfaqeson [redacted] nga Prishtina, per shperblim demi material dhe jomaterial, ne seancen e mabjtur me date 24.05.2013, ne pranine e palëve ndërgjyqjese, në të njëjtën ditë muarr këtë:

A K T G J Y K I M

PJESËRISHT APROVOHET, kërkesëpadia e paditësit [redacted] ashtu që **OBLIGOHET** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve-Prishtine, që paditësit në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial dhe material, t'ia paguaj shumën **24,103.00 €**, specifikuar si më poshtë:

Në emër të dëmit jomaterial:

- për dhimbje trupore fizike shumën6.500.00 €,
- për frikën e përjetuar shumën 4.500.00 €,
- për shëmtim shumën 3.000.00 €
- për zvogëlimin e përgjithshëm të aktivitetit jetësor shumën ... 7.000.00 €

Në emër të dëmit material:

- për ushqim të përforcuar shumën 180.00€,
- për ndihëm dhe kujdesin e personit të tretë 300.00 €,
- për shpenzimet e mjekimit shumën 701.00 €
- për fitimin e munguart për shkak të humbjes së aftësisë së përkohshme të punës shumën 260.00 €,
- për motocikletën e dëmtuar shumën 1.662.00 €

,së bashku me kumatën, e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta te qytetareve, te afatizuara për periudhë një vjeqare, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 29.05.2008 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedurë ne shumë prej 1,188.40 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishëmrisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbairmit me dhunë.

REFUZOHET, pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumave të aprovuara, si e pabazuar.

A r s y e t i m i

Pretendimet e padisë mbështeten në faktin se si pasojë e aksidentit në komunikacionit i cili ka ndodhur me datë 29.05.2008, për shkak të veprimeve te paligjshme të ndërmarra nga shkaktuesi i dëmit, ka pësuar dëm jomaterial dhe material në shkallën si ka pretenduar në padi, për c'gjë e paditura është përgjegjëse mbi bazën e autopërgjegjësinë dhe se e njëjta mbi këtë bazë ka detyrimin për kompensimin e dëmit paditësit. I aknë kërkuar shpenzimet e procedures kontestimore.

E paditura, përmes të përfaqësuesit të saj ka deklaruar se nuk është kontestues fakti se e paditura është përgjegjëse për shpërblimin e dëmit, por kanë kontestuar lartësinë e shumave të kërkuara nga paditësi në emër të lëndimeve të pësuar si tejet të larta të cilat nuk eprkojnë me natyrën dhe shkallën e lëndimeve dhe praktikën gjyqesore.

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, në kuptim të nenit 7 paragraf 1 të LPK-së, për atë që palët ndërgjyqëse i propozuan kësaj gjykate, bëri administrimin e provave si vijojnë: Raporti policor dt. 29.05.2008 së bashku me skicën nga vendi i ngjarjes, raporti i QKUK Prishtinë dt.29.05.2008 nr.17713, fletëshimi i Klinikës Ortopedise nr 747, raportet e ordinancës akustike dr. [REDAKTUAR], , raporti ordinancës Rezonanca Prishtinë, fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes, raporti për kontributet tërëmuore, listat e pagave të NTP Noli-mega market Shtime, policia e sigurimit 0000736351, lexohet emndimi dhe konstatimi dr [REDAKTUAR] dt. 20.07.2008, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit dt. 19.08.2008, kontrata e punës e lidhur me paditësin dhe NTP Noli date 01.01.2008, aktgjykimi penal P nr 242/09 date 30.08.2010, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të ortopedise dhe neuropsikiatrise dt. 12.02.2013, ekspertiza e mekanikes dt. 24.02.2013, ekspertiza e komunikacionit eks [REDAKTUAR] dt. 03.04.2013, faturat për shpenzimet e mjekimit.

Gjykata pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e propozuara vec e vec si dhe të ndërlidhura në mes veti si tërësi, , në kuptim të nenit 8 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së kur ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv.

Në grupin e fakteve jokontestuese në mes palëve ndërgjyqëse, ka gjetur faktin se e paditura është civilisht përgjegjëse për shpërblimin e dëmit paditësit, në bazë të nenit 173 lidhur me nenin 178 LMD-së si dhe mbi bazën e rregullave mbi autopergjegjesinë.

Në grupin e fakteve kontestuese, në mes palëve ndërgjyqëse, ishin faktet lidhur me lartësinë e shumave të kërkuara në emër të lëndimeve të pësuar dhe dëmit material, të cilat i kundërshtuar si jo në harmoni me mendimin e dhënë nga ekspertët mjekësor si dhe praktikën gjyqesore.

Gjykata lidhur me vërtetimin e natyrës, shkallës, intenzitetit, kohëzgjatjes dhe pasojave të lëndimeve që ka pësuar paditësi nga fakti i paligjshëm, sipas propozimit të paditësit ka bërë marrjen e provës me anë të ekspertimit nga lëmi i ortopedise-traumatologje Dr. [REDAKTUAR] dhe Dr. [REDAKTUAR] neuropsikiater.

Ekspertët në mendimin dhe konstatimin e tyre të bërë me datë 12.02.2013, kanë gjetur se paditësi si pasojë e aksidentit që ka pësuar me datë 29.05.2008, ka pësuar këto lëndime:

- Plagë shqyerse në regjionin e nofulles së poshtme,
- Plagë shqyerëse e gishtit të tretë të dorës së djathtë,
- Frakturë shumëfragmentarësh e hapur e shkallës së II-të e patelles së djathtë .

Ekspertët lëndimet e tilla i kanë kualifikuar si lëndime të natyrës së rëndë të cilat lëndime kanë pasqyellë tek paditësi dhimbje fizike të intenzitetit posacerisht të lartë në kohëzgjatje prej 30 minutash (deri në dhenien e ndimes së pare-veprimit të analgjeticëve), e cila është reduktuar më pas në intenzitet të lartë për 2 ditë deri me marrjen e terapisë adekuate, me pas ka kaluar në intenzitet të mesëm për tri javë dhe mëtej në intenzitet të ulte 2 muaj. Gjykata mendimin e ekspertëve lidhur me dhimbjes e pësuar të paditësit i aprovoi si të drejta dhe profesionale duke patur parasysh natyrën e

lendimeve që ka pësuar paditësi deri në këndellje, dhe mbi bazen e nje konstatimi te tille profesional te eksperteve ka vleresuar si te drejte shumen e gjykuar me emer te kesaj figure te demit jomaterial ne emer te satisfaksionit moral.

Eksperti i neuropsikiatrisë dr. [REDAKTUAR], në mendimin dhe konstatimin e tij, ka dhene mendimin se tek paditësi ka qenë prezente frika primare në kohëzgjatje prej disa sekondash për shkak se paditësi e ka parë me sytë e tij ne momentin e aksidentit dhe se ka menduar pasojat tragjike te ketij aksidenti gjate kesaj kohe. Me pas frika tek ai ka kaluar ne intenzitet te larte e cila eshte manifestuar tek paditesit si preokupim per gjendjen e shendetit te tij ne te ardhmen, aktiviteteteve shtese rreth mirëmbajtjes se imobilizimit, kerkesave nga personi tjeter per ta ndihmuar dhe mendimi se lendimet e pesuara do t'i shkaktojne pasoje per jetë atij, gje e cila ka shkaktuar nga ai merzitje dhe ankth, depression dhe pagjumesi. Gjykata konstatimin e ekspertit te neuropsikiatrisë lidhur me natyren, intenzitetin dhe kohëzgjatjen e frikes, i aprovoi si te drejta dhe profesionale dhe mbi bazen e ketij mendimi ka gjykuar pjeserisht paditesit shumen e kerkuar ne emer te kesaj figure te demit jomaterial.

Tek paditësi është vërtetuar se ai ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë në shkallë 10%, për shkak të thyerjes së hapur shumefragmenteshe e patelles e cila i jep vështirësi në fleksionin e gjurit e cila shoqërohet me dhimbje dhe vështirësi në ngritjen e tij nga pozita ulur. Konstatimet e tilla te ekspertit te ortopedise-traumatologjise i pranoi sj te drejta dhe profesionale per cka paditesit i ka gjykuar pjeserisht shumen e kerkuar ne emer te kesaj figure te demit jomaterial.

Ekspertet kane konstatuar se tek paditesit eshte prezent shemtimi ne shkallen prej te ulte per shkak te vrases se mbetur ne gjurin e djathte ne gjatesi prej 20 cm ne pozite horizontale dhe 2cm ne pozite vertikale dhe gjykata ka prnuar konstatimet e till ate eksperteve sit e drejta dhe profesionale duke i gjykuar paditesit shumen e pjeserishme te kerkuar ne emer te kesaj figure te demit jomaterial.

Gjykata, për të gjitha këto forma të dmëit jomaterial, paditësit i ka gjykuar shumat si në dispozitiv, duke u bazuar edhe në bindjen e saj të lirë, të krijuar nga procesi i gjithmbarshëm i këtij shqyrtimi gjyqësor, me synim se shumat e gjykuara paditesit kurre nuk do te mund t'ia rikuepronin gjendjen shendetesore qe kishte para aksidentit, por se atij ky zhdemtim do t'i shërben si satisfaksion moral, për të mirat e që ka humbur në dëmtimin e shëndetit të tij i cili ka shkaktuar ndryshime tronditese ne menyren e te jetuarit te tij duke ja shmangur mundesite per te shfaqur personalitetin e tij ne arredheniet shoqerore dhe kjo pagesë tek ai do te ketë sado pak ndikim pozitiv në këndelljen e shëndetit të tij në të ardhmen duke krijuar tek ai ndjenjen e besimin per vazhdimin e jetes se metejme.

Gjykata shumat e aprovuara i ka gjykuar paditëses bazuar në nenin 323 teLPK-së dhe neneve 185 par.3 lidhur me nenin 200 te LMD-se, ne emer te shperblimit i cili ne kete rast nuk ka qellimin e rikthimit te te mires se demtuar tek paditesit, por se ka per qellim rivendosjen e ekuilibrit te c' rregulluar ne gjendjen shpirtore te paditesit, duke i dhene atij një statisfaksion moral, se dikush eshte gjetur fajtor per prishjen e shendetit te tij per c'gje i eshte detyruar atij me kete forme te "shperblimit te demit te plote". Me rastin e percaktimit te shumave te gjykuara gjykata pati parasysh edhe personalitetin e

paditesit, te mirat e cenuara te tij, veprimtarine qe ka kryer ai dhe ndikimin e veprimit te paligjshem (aksidentit) ne personalitetin e tij.

Gjykata, i ka gjykuar paditesit shumen prej 206.00€ ne emer te kompensimit te demit material (fitimit te munguar), per shkak te pamundesise se vijimit te punimeve sipas kontrates se punes nga punedhenesi i tij.

Gjykata i ka gjykuar paditesit ne emer te kompensimit te demit material per demtimin e motocikletes shumen prej 1.662.00 €, mbi bazen e vleresimit qe ka dhene eksperti i mekanikes ing. [REDAKTUAR] e te cieln e ka pranuar si profesionale per te gjeturat qe ka konkluduar.

Gjykata i ka gjykuar paditesit shumen prej 701, ne emer te shpenzimeve te mjekimit, duke patur parasysh fakturat e prezantuara nga paditesi, si te bazuara.

Gjykata ka refuzuar kerkesen e paditesit per shpenzimet e rehabilitimit fizioterapeutik, per faktin se per nje shpenzim te tille ka mundur gjykates t'i provohet me prova materiale-faturo, por te njejtat paditesi nuk i ka provuar ne kete procedure.

Gjykata, paditesit i ka gjykuar, ne emer te demit material, shumën prej 300.00€, në emër të ndihmës dhe përkujdesjes së personit të tretë per 4 muaj dhe shumen prej 180.00€ per ushqimin e perforcuar, duke patur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditesi, posacerisht lëndimi- fracture shumefragmenteshe, qe per gjykaten e bëne te besueshëm faktin se paditesi doemos ka patur nevojë për ndihmen e nje personi te trete, për të kryer nevojat më elementare te jetësore dhe gjithashtu ushqimi me kalori, vitamina dhe minerale ka qene i nevojshem per te rigjeneruar qelizat ne rikuperimin dhe konsolidimin e pjesës kockore te dëmtuar.

Ketë vlerësim gjykata e mbështet në bindjen e saj të lirë bazuar në nenin 323 te LPK-së, te cilen e ka krijuar duke u nderlidhur me konstatimet e eksperteve respektiv, per faktin se tani eshte notore per gjykates qe paditesi ka shfrytezuar ndihmen e personit te trete dhe se ai ka konsumuar ushqim te perforcuar, andaj gjykata ka gjykuar shumat e lartecekura mbi bazen e bindjes se saj te lire.

Vendimin mbi shpenzimet e procedures kontestimore gjykata e ka bazuar ne nenin 452 parg.3 lidhur me nenin 453 parg.1te LPK-se, duke ia njohur paditesit shumën prej 1.188.40€, dhe ate per perpilimin e padise 78.00€, per precizim padie shumen prej 52.00 €, per ekspertet mjekesor dhe ate te mekanikes shumen 450.00€, per perfaqesim nga avokati ne pesë seance shumen 604.40€.

Gjykata lidhur me kamaten ka vendosur ne baze te nenit 186 lidhur me nenin 277 parg. 1 te LMD-se.

Andaj, gjykata bazuar ne nenin 2,5,29,142 dhe 160 te LPK-se, ka vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
C.nr.334/10 date 24.05.2013

Gjyqtari
Enes Mahmeti



Keshilla Juridike: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te kopjes se tij, ne gjykaten e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate.